



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 22
Prishtinë, më 24. 11. 2008, ora 12:20
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Radmila Vujovic, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati, Naim Rustemi dhe Vezira Emrush - anëtarë.

Mungoi: z. Hajredin Hyseni, që ishte i zënë me punë zyrtare.

Të ftuar: z. Muhamed Beqiri - kryetar i SP IMN "Përparimi" nga Skenderaj.

Mbledhjen e monitoruan:

- përfaqësuesi i Presidencës së Kosovës,
- përfaqësuesi i OSBE-së,
- përfaqësuesi i KDI-së,
- përfaqësuesi i UNHCR-it dhe z. Fredik nga Asambleja Kombëtare Franceze - Projekti për mbështetje të Kuvendit.

- Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj dhe Sulltane Gashi

Mbledhjen e kryesoi Ismet Beqiri - kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
- 2 Shqyrtimi i disa peticioneve,
- 3 Formimi i panelit rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit,
- 4 Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

***Kryetari** konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.*

2. Shqyrtimi i disa peticioneve

Kryetari – i përshëndeti dhe i njoftoi të pranishmit se Komisioni kohë më parë ka vendosur t'i ftojë përfaqësuesit e SP IMN "Përparimi" nga Skenderaj më qëllim që për së afërmi të informohen për problemet lidhur me mënyrën e privatizimit të ndërmarrjes nga ana e AKM-së. Po ashtu të pranishmin e njoftoi se fuqia juridike e Komisionit është rekomanduese dhe ofron këshilla se në cilin organ mund të realizohen të drejtat. Pastaj e ftoi përfaqësuesin e Sindikatës ta merrte fjalën.

Z. Muhamed Beqiri - Komisionin e përgëzoi për punën që është duke e bërë dhe kërkoi që kërkesat e tyre të gjejnë mbështetje juridike në zgjidhjen e problemeve sociale që janë shkaktuar si pasojë e privatizimit nga AKM-ja. Ai e ngriti çështjen e ish-punëtorëve që nuk janë përfshirë në punë. Diskutoi edhe për pozitën sociale, duke cekur se deri më tani kërkesat e tyre nuk kanë gjetur mbështetje institucionale. Në fund ripërsëriti nevojën që të gjenden mekanizma për zbutjen varfërisë së punëtorëve që kanë mbetur jashtë procesit të privatizimit.

Drita Maliqi – Ia shtroi disa pyetje parafolësit për vitin e themelimit të ndërmarrjes, për mënyrën e funksionimit, për vitin e largimit të punëtorëve nga puna dhe për mënyrën e privatizimit nga AKM-ja.

Ibrahim Makolli - Peticioni i ofruar ka mbështetje ligjore dhe disa ligje e rregullojnë këtë fushë. Të njëjtat probleme i kanë të gjitha ndërmarrjet që kanë kaluar nëpër procesin e privatizimit. Theksoi se në vitet 90 ka pasur mashtim kolektiv të punëtorëve, të cilëve u thuhej të mos i pranonin masat e dhunshme dhe u premtonte se pas ndryshimeve të raporteve sërish do të ktheheshin në vendet e tyre të punës, por kjo nuk ndodhi. Në vazhdim tha se ky rast do t'i shërbejë Komisionit si praktikë.

Prof dr. Nerxhivane Dauti – E paraqiti punën e Komisionit për shqyrtimin e peticioneve. Ajo i shtroi dy pyetje: *Kush e udhëheq ndërmarrjen? A ka mundësi që punëtorët e nënshkruar në peticion të sistematizohen në punë të tjera?*

Sanije Alijaj – U angazhua që punëtorët t'i realizojnë të drejtat e veta të garantuara me ligj. I mbështeti diskutimin dhe pyetjet e shtruar nga znj. Maliqi.

Naim Rustemi – Diskutoi lidhur me mënyrën e privatizimit dhe shtoi se ka munguar transparencë nga ana e AKM-së dhe ka pasur shkelje të drejtave të njeriut. Ai rekomandoi komisionin në njërin nga mbledhjet e radhës të ftohet drejtori Agjencionit Privatizimit *Komisioni e mirëpriti propozimin e parafolësit dhe nxori këtë*

Përfundim

Komisioni dhe Agjencioni i Privatizimit të Kosovës ta mbajnë një takim me qëllim që të informohen për mënyrën e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Prof dr. Nerxhivane Dauti – Në cilësinë e raportueses lidhur me shkresën nr. 1009/08 të datës 21. 5. 2008, kërkoi që sërish të shqyrtohet çështja e kthimit të ankuesit në punën e mëparshme.

Komisioni konkludoi se për realizimin e së drejtës për marrëdhënie pune, ankuesi t'i drejtohet Gjykatës Komunale të Podujevës.

3. Formimi i panelit rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit

Kryetari - Diskutoi për rëndësinë e panelit dhe arsyetimin e mbështeti në përfundimin e Kryesisë së Kuvendit për formimin e panelit rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit nr. 03 – P-054/k të datës 18 nëntor 2008.

Komisioni pas votimit për kandidatët e propozuar e mori këtë

V e n d i m

1. Për formimin e panelit rekrutues të përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit në këtë përbërje:

- *Ismet Beqiri* (GP-LDK)
- *Nerxhivane Dauti* (GP-PDK)
- *Ibrahim Makolli* (GP-AKR)
- *Shpresa Murati* (GP-7+1)

Naim Rrustemi - Pati vërejtje për procedurën e anulimit të konkursit për Avokatin e Popullit, si dhe për mënyrën e propozimit të anëtarëve të panelit të ofruar, që nuk janë në pajtueshmëri me Rregulloren e punës.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 25.

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri